

# KARTËMONEDHA 1000 LEKË KARTËMONEDHA JONË E RE: E SIGURT DHE MODERNE

## PSE NJË SERI E RE?

Një nga përgjegjësitë kryesore të Bankës së Shqipërisë është të garantojë besimin e publikut në paranë tonë kombëtare. Ajo e bën këtë duke emetuar një kartëmonedhë që i komunikon publikut shqiptar siguri dhe qëndrueshmëri. Mbi 20 vjet pas hedhjes në qarkullim të serisë së vjetër të kartëmonedhave Lek, natyrshëm kishte lindur nevoja e përmirësimit me elemente të reja sigurie, për t'i bërë ato më të sigurta ndaj falsifikimit. Kartëmonedhat tona shërbejnë edhe si mbartëse të identitetit kombëtar. Përmes mjeshtrisë artistike, ato promovojnë historinë e Shqipërisë dhe theksojnë kontributet e personaliteteve të saj.

Për këto arsye, nga viti 2019, Banka e Shqipërisë filloi emetimin e një serie të re të kartëmonedhave Lek, me pamje të rifreskuar dhe elemente sigurie të përmirësuara. Kjo seri është prodhuar me teknologjinë më të fundit të fushës, duke u kujdesur njëkohësisht që edhe pamja e kartëmonedhave të jetë më moderne.

## PREZANTIMI GRADUAL I SERISË VAZHDON

Pas hedhjes në qarkullim të kartëmonedhave 200 dhe 5000 Lekë të serisë së re në vitin 2019, vijon plotësimi i serisë me prezantimin dhe më pas hedhjen në qarkullim të prerjes 1000 Lekë.

Kartëmonedhat ekzistuese të kësaj prerjeje, do të vazhdojnë të qarkullojnë dhe të kenë kurs ligjor si mjet pagese, së bashku me kartëmonedhat e reja.

## KËSHILLA PËR PËRDORIMIN E KARTËMONEDHAVE

### Kartëmonedha përbën një vlerë kombëtare.

Trajtoje kartëmonedhën ashtu siç është: më shumë se një letër me vlerë. Përveçse mbart vlerën nominale, ajo paraqet një ndërthurje të vlerave artistike me elemente të identitetit kombëtar.

### Ruaje kartëmonedhën në portofol.

Mos e dëmto duke e rrudhosur, përthyer, shkruar, ngjyrosur, prerë, ngjitur ose lagur atë. Kështu, ti ndihmon që ajo të qëndrojë në qarkullim sa më gjatë.

### DHE MOS HARRO!!!

Lexo dhe përdor shifrën që shkruhet mbi kartëmonedhë! Mos i shto një 0! Mos e quaj as lek i vjetër, as lek i ri! Ai është thjesht LEK. Kërkoju edhe të tjerëve ta respektojnë atë, njësoj si ti.

1000

BANKA E SHQIPËRISË



1000

A  
A  
O  
O  
O  
O  
O  
O

GUVERNATORI

# ELEMENTET E SIGURISË

Kontrollo nëse kartëmonedha është e vërtetë, përmes verifikimit të elementeve të sigurisë me metodën "PREK, SHIKO, LËVIZ".

## PREK

Preke dhe ndieje kartëmonedhën me gishta.

Letra e kartëmonedhës është prodhuar nga pambuku dhe karakterizohet nga një tingëllim dhe konsistencë e veçantë.

- 1 Shtypi i ngritur.** Ndieje shtypin e ngritur të vlera nominale, tekstet dhe portreti. Ndiej vijat e shkurtra përgjatë anës së majtë dhe të djathtë të kartëmonedhës, që përbëjnë elementin e njohjes nga personat me aftësi të kufizuara shikimi.

## SHIKO

Mbaje kartëmonedhën kundrejt dritës dhe shikoje me kujdes.

- 2 Figurat ujore.** Portreti i kartëmonedhës, vlera nominale e saj dhe simboli i stilizuar i shqiponjës bëhen të dukshme.
- 3 Filli i sigurisë.** Nga një shirit i ndërprerë, filli i sigurisë duket një vijë e errët e pandërprerë. Në të dallohen vlera 1000 Lekë dhe një stilizim i simbolit të diellit.
- 4 Figura me ngjyrë të ndryshueshme.** Simboli i diellit në këndin e sipërm djathtas ndryshon ngjyrë, nga e artë në të gjelbër, me një efekt dinamik të figurës sipas këndit të lëvizjes.
- 5 Filli i sigurisë** ndryshon ngjyrë nga e gjelbër në të purpurt.
- 6** Në faqen e pasme të kartëmonedhës, **shiriti i shndritshëm** në zonën qendrore shfaq të shkruar vlerën 1000 Lekë.

